

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nuhiu: Kodi Zgjedhor ka nevojë urgjente për ndryshim, në lojë edhe fondet e BE-së
ADRESA	https://albeu.com/maqedoni/nuhiu-kodi-zgjedhor-ka-nevoje-urgjente-per-ndryshim-ne-loje-e-dhe-fondet-e-be-se/1020074/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 15:11:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 15:08:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9d8b0c05419fa60c125b39c61c7978e10469e32463e9c1918ef6d3ec01d22919
TEKSTI	ed9cd34b41d6650c1330b99b2d255a868ee400b451fed1aff8498cd07491de0a
PAMJA	af439560944bfff9ec2b5ef595b343849a47cfd593d876383deeec1405683f99f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	48e18657476c7996c08e979afe9a9cc4289a0be0e92461b447fddbf1ac7d2992
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ac48a4064545432ea373f4e7d0b56014d8dcbe9272af7bcd7f79339adcddebee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/48e18657476c7996c08e979afe9a9cc4289a0be0e92461b447fddbf1ac7d2992>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nuhiu: Kodi Zgjedhor ka nevojë urgjente për ndryshim, në lojë edhe fondet e BE-së



Përfaqësues të institucioneve dhe ekspertë theksojnë se reformimi i Kodit Zgjedhor është i pashmangshëm. Megjithatë tashmë ka përpjekje për ta miratuar atë, procesi ende ndodhet në fazë negociatash.

Politologu Qani Nuhiu, në një deklaratë për TVM-2, nënvizon se këto ndryshime duhet të kryhen pa vonesë, sepse legjislacioni aktual zgjedhor nuk i përgjigjet më kohës.

"Kuadri ligjor që përcakton procesin zgjedhor është një element tejet i rëndësishëm i sistemit politik dhe i zhvillimit demokratik të një vendi. Kjo lëndë kërkon një kompromis të gjerë në një shtet politiko-etnik, pra në dy segmente, meqë pavarësisht se sa të mëdha ose të vogla janë partitë në parlament, të gjitha duhet të bien dakord për një model të caktuar. Kjo forcon kohezionin politik dhe rrit legjitimitetin e ligjit përkatës, pra të Kodit Zgjedhor tek të gjitha subjektet, duke u dhënë mundësi të barabarta. Në rastin e Maqedonisë së Veriut, edhe ndryshimet e ardhshme duhet të kenë parasysh këtë dimension", u shpreh Nuhiu.

Ai shton se krahas kërkesave të brendshme, edhe presioni i faktorit ndërkombëtar për ndryshime është i konsiderueshëm.

"Andaj është momenti i fundit që ky sistem zgjedhor, konkretisht Kodi Zgjedhor, të pësojë transformimet e nevojshme për të cilat do të arrihet marrëveshja. Idealisht, do të ishte mirë që të përfshihen të gjitha partitë politike, ose një shumicë dërrmuese që do të pajtohet, dhe ndryshimet të realizohen në atë mënyrë. Kjo sigurisht që do t'i përgjigjej kohës, sepse kodi aktual nuk u bën ballë sfidave; ai u miratua në vitin 2002 dhe ka pësuar mbi 30 ndryshime deri tani. Prandaj lind nevoja për ta hartuar atë në mënyrë të qartë dhe të zbatueshme për institucionet zgjedhore, si dhe për të gjetur zgjidhje që i qëndrojnë kohës, me qëllim final demokratizimin e shtetit, shoqërisë dhe një përfaqësim sa më të mirë për qytetarët e Maqedonisë së Veriut", përfundoi politikologu.

të fundit /



Lista e barnave thelbësore rinfreskohet pas një dekade,...



Foto/ Kim Kardashian tërheq vëmendjen në galanë e muzeut të...



Isak i jep Liverpoolit fitoren e dytë në Ligën Premier



Përplasje në rrugën Maqellarë-Peshkopi, nënë e bir dërgohen ...



Sipas Bardhit, Rama u takua me Ergys Agasin para arrestimit dhe...



Iliria surprizon pretendentin për Superiore në një duel...



Mbi një mijë sulme kibernetike ndaj procesit zgjedhor në...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Reformuese. Per kete arsye, pertej domosdosmmerise politike, mosmiratimi i tyre ve ne pikepyetje edhe 4.28 milionë euro të lidhura me këtë reformë në kuadër të Planit të Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor.

Shtuar më 20.09.2026 17:08

Tags: Kodi zgjedhor maqedoni , Sistemi zgjedhor



Lista e barnave thelbësore rifreskohet pas një dekade, qytetarët kërkojnë më...



Dimitrievski: ZNAM kërkon një tjetër post zëvendësministri në Qeveri



Arrestohet 65-vjeçari pas aksidentit fatal në autostradën Kumanovë-...



Shporta minimale sindikale për shtatorin shkon në 69.432 denarë



OBRM-PDUKM akuzon LSDM-në për cenim të interesave kombëtare



Osmani: Modeli i Tirolit të Jugut ofron përvoja për fuqizimin e Marrëveshjes...



Prokuroria ngre akuzë ndaj gjashtë personave për leje drejtimi të falsifikuara



LAMM: Qarkullim pa vonesa të mëdha në pikat kufitare



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.